



Datë: 16.06.2025
Numër Protokolli: 4917/2025

A.nr.794/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.794/2025, të datës 02.05.2025, të parashtruar nga ankuesja, N.M, kundër organit të punësimit: Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.794/2025, e datës 02.05.2025, e parashtruar nga ankuesja, N.M.

A r s y e t i m

Ankuesja, N.M (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), më datë 02.05.2025, përmes postës elektronike (ankesa.kpmschck@rks-gov.net), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me nr.ref: RN00014971, për Grupin e Shkencave Shoqërore, respektivisht për pozitën e punës Zyrtar për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim, të shpallur nga Komuna e Gjilanit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa **është e palejuar**, sepse:

Nga administrimi i provave materiale të çështjes rrjedhë se Komuna e Gjilanit, më datë 06.09.2024, ka shpallur konkursin publik me numër reference RN00014971, për Grupin e Shkencave Shoqërore, për pozitën Zyrtar për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim, me klasë të pozitës profesional 2, një (1) vend i lirë pune, me afat aplikimi nga data 07.09.2024 deri më datë 06.10.2024. Në këtë konkurs kishte aplikuar edhe ankuesja, mirëpo, sipas Njoftimit me numër protokolli Nr.115862/24, të datës 23.10.2024, të Njësisë së Personelit të Komunës së Gjilanit, ankueses i ishte refuzuar aplikacioni, me arsyetimin se i mungon provoja profesionale, për pozitën e shpallur. Pas përfundimit të vlerësimit profesional, Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit më datë 22.11.2024, kishte publikuar Njoftimin për kandidatin e suksesshëm për pozitën Zyrtar për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim, nga i cili njoftim rezultoi se si kandidatë më shumë pikë ishin shpallur F.R me 97 pikë, R.P me 88 pikë dhe D.A me 77 pikë.

Me tej, sipas provave materiale të kësaj çështje del se kandidati K.S, kishte kundërshtuar më ankesë njoftimin e datës 23.10.2024 lidhur me refuzimin e aplikacionit po në procedurë të njëjtë, ndërsa, Këshilli me Vendimin A.nr.1792/2024, të datës 12.02.2025, ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit, duke anuluar Njoftimin e datës 22.11.2024, për shpalljen e rezultatit përfundimtar, ashtu që, çështjen e kthyen në fazën e vlerësimit të aplikacioneve, gjegjësisht në vlerësim paraprak. Në zbatim të Vendimit të Këshillit A.nr.1792/2024, të datës 12.02.2024, Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, pas rivlerësimit të aplikacioneve të kandidatëve, përmes Njoftimit me numër reference 373, të datës 13.03.2025, ka njoftuar kandidatë të cilët kanë plotësuar kriteret e konkursit, përfshirë edhe ankuesen, kurse më datë 26.03.2025, kandidatët ishin njoftuar më kohën dhe vendin e mbajtjes së testit më shkrim, gjegjësisht testi ishte planifikuar të mbahej në datë 07.04.2025 në ora 14:30, mirëpo, që sipas shkresave të lëndës vërehet së ankuesja nuk ka marrë pjesë.

Rrjedhimisht, procedura e kontestuar kishte përfunduar më datë 17.04.2025, ku njësia përgjegjëse e institucionit përkatës ka shpallur listën përfundimtare të kandidatit fitues, e sipas së cilës listë kandidati D.A është shpallur si kandidati më më shumë pikë të arritura, gjithsej 88.6 pikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, thekson së më datë 13.10.2024 ishte njoftuar se aplikacioni i saj ishte refuzuar për shkak së e njëjta nuk ka përvojën e punës së kërkuar më konkurs, ndërsa, shton se “ *për çudi më datë 13.03.2025 kam pranuar emal për përshije në listën e ngushtë, kurse më datë 26.03.2025, njoftohem për pjesëmarrje në testin më shkrim më datë 07.04.2025, edhe pse konkursi ishte mbyllur dhe nuk kishte pas shpallje te re, andaj, sipas ankueses ky zhvillim kontradiktor ka krijuar paqartësi të mëdha dhe dyshime mbi transparencën dhe rregullsinë e procesit. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të verifikoj nëse është respektuar kjo procedurë drejtë dhe në mënyrë transparente.*

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 4 ku përcaktohet se: “*4. E drejta e ankimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo kandidateje/i në procedurë pranimit në shërbimin civil*”, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 14 ku përcaktohet se “*Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative*”, nenit 103 paragrafi 2, ku përcaktohet se: “*2. Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, gjithashtu do të përfundohet, kur nga rrethanat rezulton pa asnjë dyshim se pala nuk ka më interes në vazhdimin e saj dhe e ka braktisur atë*”, si dhe nenit 124 paragrafi 1, të të njëjtit ligj me të cilin parashihet se: “*Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim,*”, dhe si rrjedhojë referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankueses në rrethanat e rastit konkret nuk i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik, pasi që ankuesja më vet dëshirë ka braktisur pjesëmarrjen në procedurën përkatëse të rekrutimit, gjegjësisht, në testin me shkrim. Andaj, dhe si rrjedhojë i njëjta nuk ka legjitimitetin e palës në këtë çështje juridiko-administrative, dhe rrjedhimisht në mungesë të legjitimitetit të palës, ankesa A.nr.794/2025, e datës 02.05.2025 është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa me sipër, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.981/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses, N.M;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së